

P R O G R A M I

**për mirëmbajtjen e pastërtisë publike për vitin 2022 në
Komunën e Kërçovës**

Kërçovë, Dhjetor 2021

PROGRAMI

PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTISË PUBLIKE NË KOMUNËN E KËRÇOVËS PËR VITIN 2022

Hyrje

Me këtë program përcaktohen punët për mirëmbajtje të pastërtisë publike në territorin e Komunës së Kërçovës, për vitin 2022, dhe atë në llojin dhe vëllimin e punëve që duhet të kryhen dhe aktivitetet që duhet të ndërmerrën, dinamika dhe mënyra e kryerjes së punëve dhe mënyra e financimit të tyre. Të gjitha aktivitetet dhe punët që duhet të ndërmerrën për mirëmbajtjen e pastërtisë publike janë në varësi të më shumë faktorëve, si nga dendësia e popullatës, frekuencia e njerëzve dhe automobilave, kushtet infrastrukturore dhe nevojat institucionale dhe qytetare, shkalla e pastërtisë etj.

Ligji për pastërtinë publike, me të cilin rregullohen kushtet dhe mënyra e mirëmbajtjes së pastërtisë publike, të drejtat dhe obligimet e pjesmarrësve në mirëmbajtjen e pastërtisë publike, është akt me të cilin ligjvënësi ka për qëllim që më rregullisht ta mirëmbajë pastërtinë publike, ndërsa kjo është një gjë që e shtyn vetë jetesa urbane. Gjegjësisht, me këtë ligj parashihet pagesa e kompensimit për mirëmbajtje të pastërtisë publike, me çka pritet burimi i mjeteve të jetë i siguruar, me çka dhënësit e shërbimeve do të jenë në mundësi që në mënyrë sa më efikase ti kryejnë aktivitetet e mirëmbajtjes së pastërtisë publike. Lloji dhe mënyra e mirëmbajtjes së pastërtisë publike, mes tjerash, varet drejtpërdrejt nga rregullimi, gjendja/mirëmbajta e sipërfaqeve publike frekuentuese dhe pajisjes së tyre adekuate komunale/qytetare. Prandaj si ndërmarrje potencojmë që mund të ofrojmë shërbim më të mirë në vëllim, dinamikë dhe kualitet, në qoftë se, kushtet infrastrukturore në Komunën e Kërçovës përmirësohen, ndërsa respektimi i rendit komunal, rregullat e komunikacionit dhe tjerë, të ngriten në nivel më të lartë nga aktualja.

Nën termin mirëmbajtja e pastërtisë publike nënkuftohet:

- Pastrimi (larja dhe fshirja) e sipërfaqeve publike dhe hapësirave të hapura të objekteve publike
- Pastrimi i dëborës në kushte dimërore.

Mirëmbajtja e pastërtisë publike paraqet proces të vazhdueshëm që siguron pastrimin e përhershëm dhe kualitativ të sipërfaqeve publike. Për realizimin e këtyre aktivitetave NP “Komunalec”- Kërçovë, përgadit program vjetor për mirëmbajtjen e pastërtisë publike për vitin 2022.

Me Programin për mirëmbajtjen e pastërtisë publike për vitin 2022 janë të përcaktuara: lloji dhe vëllimi i punëve që duhet të kryhen, mjetet financiare për kryerje të punëve, afatet kohore për kryerjen e punëve, dinamika dhe mënyra e kryerjes së punëve, si dhe vendosja e shportave për mbeturina në sipërfaqet publike.

1. LLOJI DHE VËLLIMI I PUNËVE:

Në planifikimin dhe dimenzionimin e punëve, puna e dorës dhe mekanizimi për mirëmbajtjen e pastërtisë së sipërfaqeve publike si faktor kyç janë marrë:

-Percaktimi i nivelit dhe dinamikës së mirëmbajtjes së pastërtisë publike komunale për sipërfaqet publike (kategorizimi)

-Dimenzionet, lloji dhe forma e sipërfaqeve publike (madhësia)

-Mënyra e mirëmbajtjes së pastërtisë publike

-Llogaritja e normave të punës mbi të cilat kryhet dimenzioni i punës, puna e dorës dhe mekanizimi

Origjina dhe lloji i mbeturinave të sipërfaqeve publike

Nën termin mbeturina nënkuptohej mbledhje e mbeturinave që krijojnë gjatë mirëmbajtjes së pastërtisë publike.

Nën termin mbledhja e mbeturinave nënkuptohej largimi i mbeturinave të krijuara dhe vendosja në shporta për mbeturina.

Sipas mënyrës së jetesës dhe punës të njerëzve mirëmbajtja e pastërtisë publike është e kushtëzuar nga këto faktorë:

-Dendësia e popullsisë

-Komunikacioni qytetit

-Hapësira banimi

- Shprehitë kulturore të popullsisë

-Standardi

-Vetëdisiplina e qytetarëve

-Respektimi i rregullave pozitive

Nga këto faktorë është i kushtëzuar dhe shkalla e ndotjes së sipërfaqeve publike, mënyra dhe dinamika dhe mirëmbajtjes të së njejtave.

1.1. Mbeturina të përditshme

a) Mbeturinat nga automjetet që krijojnë gjatë:

- gjatë transportit të materialeve të ndryshme (material ndërtimi, fruta, perime dhe materiale teknologjike)

- gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave të ndryshme

- gjatë mbledhjes së mbeturinave të amvisërisë

- gjatë kositjes së sipërfaqeve të barit

b) Ndotja e atmosferës

- ndotja nga tymi, pluhuri
- oxhaçet industrial
- gazrat nga automjetet motorike

c) Gjatë reshjeve intenzive të shiut

- sedimentet nga toka, rëra, gjethet etj.

1.2 Mbeturina sezonale

Shfaqet sezonalisht dhe zakonisht ka dy lloje

-gjethe nga drunjtë, degët e thata dhe të ngjajshme

-rërë, skorje dhe gurë të vegjël i cili në periudhën e dimrit përdoret për spërkatje në hapësira publike për të zvogëluar rrëshqitjen e cila pas ndërprerjes së ngricave dhe borës duhet të hiqet tërësisht.

2.DINAMIKA, MËNYRA DHE AFATET KOHORE PËR KRYERJEN E PUNËVE

Për përpunimin e planit organizativ për pastrimin e sipërfaqeve publike një nga faktorët kryesorë është kategorizimi i sipërfaqeve publike. Kategorizimi i sipërfaqeve publike mvaret nga: dendësia e qytetit, orari i objekteve punuese dhe hapësinore, intenzitetit të komunikacionit.

Duke pasur parasysh përvojën e viteve të mëparshme, ne propozojmë kategorizimin e mëposhtëm:

I. -Kategoria:

Sipërfaqet e trafikut publik në qendër të qytetit dhe pjesës tregtare të qytetit ku rrugët, trotoaret, plakat janë me frekuencë më të lartë levizjeje.

Vëllimi i punëve: pastrim i kombinuar manuale dhe makinerike e sipërfaqeve publike, zbrasja e shportave rrugore për bartje të mbeturinave me karroca manuale deri në depo të përkohshme.

Punët e kësaj kategorie do të realizohen çdo ditë të vitit ditë e natë në varësi të kushteve kohore dhe vëllimit të punës, me përjashtim të periudhave dimërore gjatë rrëshjeve të mëdha të dëborës dhe paraqitja e ngricave gjatë natës.

II.-Kategoria

Sipërfaqet e trafikut publik në qendër të qytetit dhe pjesës tregtare të qytetit ku rrugët, trotoaret, plakat janë me frekuencë më të lartë levizjeje.

Vëllimi i punëve: pastrim i kombinuar manuale dhe makinerike e sipërfaqeve publike, zbrasja e shportave rrugore për bartje të mbeturinave me karroca manuale deri në depo të përkohshme.

Punët do të kryhen çdo ditë pune përveq të Diellave dhe festave shtetërore, me përjashtim të periudhave dimërore gjatë rrëshjeve të mëdha të dëborës dhe paraqitja e ngricave gjatë natës.

III.-Kategoria

Rrugë dhe lagje me popullsi të dendur me qarkullim më të ulët urban dhe njerëz.

Vëllimi i punëve: pastrim i kombinuar manuale dhe makinerike e sipërfaqeve publike, zbrasja e shportave rrugore për bartje të mbeturinave me karroca manuale deri në depo të përkohshme.

Punët do të kryhen një herë në javët.

IV.-Kategoria

Rrugë dhe lagje me popullsi të dendur me qarkullim më të ulët urban dhe njerëz.

Vëllimi i punëve: pastrim manual i sipërfaqeve publike, zbrasja e shportave rrugore për bartje të mbeturinave me karroca manuale deri në depo të përkohshme.

Punët do të kryhen një herë në muaj.

V.-Kategoria

Larja e hapësirave publike bëhet me dorë me zorrë. Puna kryhet të paktën një herë në muaj 7 herë në vit pas përfundimit të muajve të dimrit.

VI.-Kategoria

Kjo kategori përfshin: heqjen e rërës, gurëve, baltës, gjethive pas shirave të rrëmbyeshëm.

VII.-Kategoria

Pastrimi i borës nga sipërfaqet publike nga Kategoria I.

Bora dhe akulli në trotoaret mblidhet në skajet e trotoarëve, dhe nëse trotoaret janë më të ngushtë se 1,5m nga skaji i rrugës ku tregohet kujdes që të mos bllokohen ulluqet dhe të mos pengohet lëvizja e automjeteve dhe e këmbësorëve. Largimi i borës dhe akullit të deponuar NP “Komunalec” – Kërçovë do të bëhet me mekanizim vetanak.

Punëtorët që e mirëmbajnë pastërtinë e sipërfaqeve publike do të punojnë në qendër të qytetit (rrugë të parapara në kategorinë I) dhe do ti kryejnë këto punë:

- Hapja e vendkalimeve për këmbësorë
- Hapja e shtigjeve për këmbësorë nëpër trotoare dhe pllaka
- Pastrimi i plotë i urave
- Pastrimi dhe zbrazja e shportave rrugore

Pastrimi i borës para objekteve (qasja deri në vetë objektin) është përgjegjësi e pronarëve dhe shfrytëzuesve të objekteve.

Punë të përkohshme:

Si punë të përkohshme paraqiten pastrimi i sipërfaqeve publike me kërkesë të Komunës gjatë kohës së festave shtetërore, me kërkesë të shërbimeve inspektuese, mbledhja e mbeturinave pas manifestimeve publike me kërkesë të organizatorit të manifestimit publike dhe të tjera. Këto punë kryhen jashtë programit të planifikuar.

Në Programin për mirëmbajtjen e pastërtisë publike për vitin 2022 nuk janë të parapara këto aktivitete:

-Mirëmbajtja e sipërfaqeve të hapësirave të hapura për objektet publike dhe oborreve të objekteve kolektive dhe individuale

-Pastrimi i deponive të egra

-Sipërfaqet e lira që nuk janë të parapara për qarkullim të trafikut

Në vitin 2021 është kryer renovimi i plotë i Kalasë së Kërçovës. Hapësira për mbledhje është rinnovuar tërësisht, është ndërtuar kupolë e re që do të shërbejë për mbajtjen e shfaqjeve, koncerteve dhe manifestimeve tjera kulturore. Është mbjellë barë i ri, janë vendosur 123 LED llamba në kandelabra, 84 drita anësore tek shkallët, 84 stola, 4 tavolina mermeri dhe 8 stola mermeri. Për funksionimin e dy shatërvanëve janë vendosur 4 mekanizma të furnizimit me ujë, të cilat janë rinnovuar tërësisht. Janë mbjellë 120 pisha, janë vendosur 7 kosha të ri të mëdhenj, 41 kosha prej pleku, 43 kosha të vegjël të dekoruar nga ana e jashtme me dru. Për banorët më të rinj të Kërçovës janë vendosur luhata të reja dhe lodra të ndryshme. Janë vendosur tre shatërvanë të rinj dhe janë ndërtuar dy belveder të zbuluar me lule dhe karrige të reja. Rruga për në Kalanë e Kërçovës është rinnovuar me pllaka të reja betoni.

Për mirëmbajtjen e Kalasë shtesë janë angazhuar edhe dhjetë punëtorë që punën e tyre e kryejnë me ndërrime edhe atë: Mirëmbajtës të sipërfaqeve qarkulluese publike (katër), për parquet (tre), punëtor për sigurim (tre).

Bazat për përcaktimin e vëllimit, kategorizimit, si dhe norma e punëve dhe detyrave të punës për pastrimin e sipërfaqeve publike janë shfrytëzuar dokumentet referente të Odës Ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

Pastërtia publike dhe gjelbërimi publik në vitin 2022 do të mirëmbahet rregullisht dhe çdo ditë në bazë të programit për mirëmbajtjen e Pastërtisë publike. Në kompenzimin e kalkuluar publik në llogari të shërbimeve të rregullta komunale Ndërmarrja do ta investojë në mjete dhe mekanizma të ri me të cilën do të përmisohet kualiteti i kryerjes së këtyre shërbimeve.

PASTRIMI I SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Mirëmbajtja e sipërfaqeve publike në teritorin e Komunës së Kërçovës do të përbëhet nga:

- Pastrimi me dorë dhe larje e rrugëve, bulevardëve, si dhe sipërfaqeve të tjera publike dhe hapësirave të hapura, si dhe objekteve publike të theksuara në ligjin për pastërti publike,

- zbranja e shportave rrugore për mbeturina, të cilat janë të vendosura në territorin më të gjerë qëndror të qytetit, dhe

- mirëmbajtja e sipërfaqeve publike në kushte dimërore.

Për kryerjen më të mirë të obligimeve të punës, sipërfaqet publike grupohen në 3 kategori (zona), ndërsa gjatë realizimit të obligimeve të punësuarve – pastrues, bëhet në orët e mëngjesit gjatë periudhës verore do të jetë (nga ora 05:00 deri në ora 12:00) ndërsa në periudhën dimërore prej ora (06:00 deri 13:00), me dinamikë të punës prej 6 ditëve në javë dhe 1 ditë të lirë. Në rrugën B.Çlirimini dhe M.Tito ka edhe ndërrim të dytë që fillon prej ora 14:00 deri ora 22:00.

Gjithashtu, do të vazhdohet me vendosjen e shportave të reja rrugore për mbeturina, duke nisur nga rajoni qëndror i qytetit, deri te pjesët periferike të qytetit, si dhe vendosja e kontejnerëve plastik për selektim të mbeturinave.

Numër i nevojshëm i punëtorëve për pastrimin e ZONËS 1.

ZONA 1. Dinamika e mirëmbajtjes – çdo ditë.

Numër rendor	Sipërfaqe publike (rrugë, trotoare etj.)	Gjatësia (m)	Sipërfaqja për mirëmbajtje (m²)
1.	Bulevardi i Çlirimini	2000x12	24.000
2.	M.Tito (prej Pirinit deri 11 Shtatori)	1200x10	12.000
3.	11-Shtatori (prej B.Kidriç deri M.Tito)	1500x10	15.000
4.	Boris Kidriç	850x10	8.500
5.	Rudnička (prej B.Çlirimini deri Pirinit)	600x10	6.000
6.	Kuzman J.Pitu	210x6	1.260
7.	11 Tetori	260x8	2.080
8.	Amit Çelopeçanec	340x6	2.040
9.	Beogradit	90x6	540
10.	Goce Delçev (prej M.Tito deri 11-Shtatori)	200x6	1.200
11.	Shtrati i lumit Sushica (pjesa me pllaka)	200x6	1.200
GJITHSEJ		7.350	73.820

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike qarkulluese në Zonën 1 janë të nevojshëm katërmëdhjetë punëtor, dhe janë të nevojshme të ndahen mjete financiare prej:

$$350 \text{ ditë} \times 73.820 = 25.837,00 \times 0,3 \text{ den} = \mathbf{7.751.100 denarë}$$

Numër i nevojshëm i punëtorëve për pastrimin e ZONËS 2.

ZONA 2. Dinamika e mirëmbajtjes – çdo të tretën ditë.

Numër rendor	Sipërfaqe publike (rrugë, trotoare etj.)	Gjatësi (m)	Sipërfaqja për mirëmbajtje (m²)
1.	J.Mihajloski (prej M.Tito deri 11-Shtatori)	900x6	5.400
2.	T.Caleski (J.Mihajloski deri 15 Nëntori)	300x6	1.800
3.	15- Nëntori (T. Caleski deri te e Vardarit)	60x6	360
4.	e Vardarit	100x6	600
5.	Karaxhiçeva	110x6	660
6.	Sande Shterjoski	160x6	960
7.	Vele Zmejkoski	240x6	1.440
8.	Ljubica Bogeska	150x10	1.500
9.	Goce Delçev (prej 11-Shtatori deri Uzhiçka)	800x6	4.800
GJITHSEJ		2820	17.520

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike qarkulluese në Zonën 2 janë të nevojshëm gjashtë punëtor, dhe janë të nevojshme të ndahen mjete financiare prej:

$$120 \text{ ditë} \times 17.520 = 2.102,400 \times 0,3 \text{ den} = \mathbf{630.720 \text{ denarë}}$$

Numër i nevojshëm i punëtorëve për pastrimin e ZONËS 3.

ZONA 3. Dinamika e mirëmbajtjes – një herë në javë.

Numër rendor	Sipërfaqe publike (rrugë, trotoare etj.)	Gjatësi (m)	Sipërfaqja për mirëmbajtje (m^2)
1.	Dr. Vllado Polezhinoski	710x6	4.260
2.	Raim Lika	320x6	1.920
3.	M. Mileski (B. Kidriç deri te e Pirinit)	330x6	1.980
4.	e Pirinit	240x6	1.440
5.	11 shtatori (nga fillimi deri te B. Kidriç)	720x8	5.760
6.	4 Korriku	1.350x6	8.100
7.	M.Tito (prej Arabella deri Rruga e Osllomesë)	1.000x6	6.000
8.	I.Akioski	590x6	3.540
9.	Krushevës	160x6	960
GJITHSEJ		5.420	33.096

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike qarkulluese në Zonën 3 janë të nevojshëm dy punëtor, dhe janë të nevojshme të ndahen mjete financiare prej:

$$52 \text{ ditë} \times 33.096 = 1.720,992 \times 0,3 \text{ den} = \mathbf{516.297,6 \text{ denarë}}$$

Numër i nevojshëm i punëtorëve për pastrimin e ZONËS 4.

ZONA 4. Dinamika e mirëmbajtjes – një herë në muaj.

Numër rendor	Sipërfaqe publike (rrugë, trotoare etj.)	Gjatësi (m)	Sipërfaqja për mirëmbajtje (m^2)
1.	“Uzhiçka Republika”	1.330x8	10.640
2.	Pashinë e Poshtme	1200x4	4.800
3.	Pashinë e Epërme	600x4	2.400
4.	Metodija Stefanoski	540x6	3.240
5.	Trotoari i rrugës magjistrale	5.000x5	25.000
6.	Rrugë të asfaltuara në lagjen Deveana	1.100x4	4.400
7.	Rrugë të asfaltuara në lagjen Karposh	1.030x4	4.120
8.	Rrugë të asfaltuara në lagjen “Konjski Livadi”	1.250x4	5.000
9.	Rrugë të asfaltuara në lagjen. Llozhionica	870x4	3.480
10.	Rrugë të asfaltuara në lagjen Kalendarica	1800x4	7.200
11.	Lagjja e re dhe rrugë të asfaltuara në Ivanidoll	1.400x4	5.600
GJITHSEJ		16.020	75.880

Për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike qarkulluese në Zonën 4 janë të nevojshëm dy punëtor, dhe janë të nevojshme të ndahen mjete financiare prej:

$$12 \text{ ditë} \times 75.880 = 910.560 \times 0,3 \text{ den} = \mathbf{273.168 \text{ denarë}}$$

SHUMA PËRMBLEDHËSE PËR TË GJITHA ZONAT

ZONA	Nr. i punëtorëve	Ditë në Javë	Orë në Javë	Ditë në Vjet
1	14	7	40	350
2	6	6	40	120
3	2	6	40	52
4	2	6	40	12

NP “Komunalec”- Kërçovë ka siguruar makina për pastrimin e rrugëve, e cila do të përdoret për pastrimin e të gjitha katër zonave të caktuara, dhe sipas nevojës në rrugë tjera me urdhëresë të Komunës së Kërçovës ose inspektorëve komunal.

Makina që e posedojmë për pastrimin e sipërfaqeve publike, do të punojë me dinamikën si në vijim:

Orë pune në ditë (2 ndërrime me 6 orë)	Ditët Mujore	Muaj në Vit
12	24	12

$$12 \times 24 = 288 \text{ x } 12 = 3.456 \text{ x } 380 \text{ den} = 1.313.280 \text{ denarë}$$

Në këtë tabelë tregohen të gjithë shumat për të katër zonat për pastrim poashtu dhe shuma për makinën për pastrim

ZONA 1	7.751,100 DENARË
ZONA 2	630.720 DENARË
ZONA 3	516.297,6 DENARË
ZONA 4	273.168 DENARË
MAKINA PËR PASTRIM	1.313.280 DENARË
GJITHSEJ	10.484.565,6

1.2 LARJA E SIPËRFQAVEVE PUBLIKE

Larja e sipërfaqeve publike të qytetit bëhet me cisternë prej 8 m³ vëllim, të cilën e shërbijnë vozitës dhe dy punëtor.

Larja dhe ujitja e sipërfaqeve publike bëhet me cisternë, e cila në pjesën e përparme ka currila dhe e njëjtë kryen dy funksione- larjen e rrugëve dhe ujitjen e sipërfaqeve të gjelbërta. Për këtë mënyrë të punës është i paraparë një ekip prej dy punëtorve, dhe atë: vozitës dhe curril. Vozitësi drejton automjetin i cili lëviz pas drejtimit të rrugës, ndërsa currili drejton me pajisjet komanduese për drejtimin e currilave për larje/ujitje.

Për shkak të gjendjes së paraqitur me virusin Kovid-19, është zmadhuar pastrimi i rrugëve dhe kryhet dezinfektimi i të njejtave me Hipoklorit Natriumi

Një autocistern i përfshin elementet vijuese të punës:

- Pajisje për mbushjen e cisternës
- Mbushjen e cisternës
- Mbledhja e pajisjes pas mbushjes

- Vozitjen e cisternës së plotë
- Larje dhe ujite e sipërfaqeve publike frekuentuese
- Vozitje deri te hidrantit përmblidhje të përsëritshme

Zona I

Numri i cisternave ditore	Ditë pune	Muaj	Punëtor të angazhuar	Ndërrime	Gjithsej numri i cisternave
2	24	9	2	/	432

Zona II

Numri i cisternave ditore	Ditë pune	Muaj	Punëtor të angazhuar	Ndërrime	Gjithsej numri i cisternave
2	10	9	2	/	180

Zona III

Numri i cisternave ditore	Ditë pune	Muaj	Punëtor të angazhuar	Ndërrime	Gjithsej numri i cisternave
2	1	9	2	/	18

Gjithsej në vit= 630 cisterna

Në vit për të tre zonat janë të nevojshme 630 cisterna x 4.000= 2.520,000

MIRËMBAJTJA E GJELBËRIMEVE PUBLIKE

Në programin për vitin 2022 janë të hartuar tregues që e trajtojnë mirëmbajtjen e objekteve, të cilat për qytetin e Kërçovës paraqesin tërësi të vetme. Nga këto arsyet, objektet e ndara në program janë të trajtuar në mënyrë të posaçme, dhe për të njëjtat, falë të dhënave të disponueshme të kadastrit janë të përgatitura shqyrtime tabelare, si për intensitetin e mirëmbajtjes, ashtu edhe për mjetet e nevojshme financiare.

1.2.1 PASQYRË KADASTRALE

Numër rendor	Lokacioni	Sipërfaqe
1.	Shtrati i lumbit Sushica	6.860 m ²
2.	Rr. "Marshall Tito"	540 m ²
3.	Rr. "Boris Kidriç"	780 m ²
4.	Rr. "Rudnička"	933,9 m ²
5.	Rr."11-të Shtatori"	15.184m ²
6.	Bulevardi i Çlirimt	5.100 m ²
7.	"Kalaja e Kales"	13.566 m ²
8.	Rr. magjistrale prej te Kazerma deri te kopaçka dhe rrethet në sipërfaqet e gjelbruara (rrethet)	7500 m ²
GJITHSEJ		51.000 m ²

Gjatë vitit 2020 në rr. Marshall Tito janë të ndërtuara edhe dy rrëth-rrotullime dhe park për pushim të qytetarëve. Poashtu janë të ndërtuar edhe tre rrëthrrrotullime në rr. "Boris Kidriç" dhe një në rr. "Isein Akioski", që duhet të mirëmbahen nga ana e NP.

**Dymbëdhjetë rrëth-rrotullime në:
rr.Bul.Çlirimit, Marshall Tito, Rruga Magjistrale, Boris Kidriç dhe Isein Akioski**

Nr. rend.	Operacioni i punës	Numri	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Masa e vetme	Shuma totale
1.	Furnizim me materiale lulore	2500	2500	/	2500	60	150.000 den
2.	Mbjellje	2500	2500	1	2500	6	15.000 den
3.	Gërmim,nxjerrje (mirëmbajtje)	2500	2500	7	17500	8	138.000 den
							GJITHSEJ: 303.000 den.

Kalaja Kitino dhe zhardinjeri në rr.Bul.Çlirimit

Nr. rend.	Operacioni i punës	Numri	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Masa e vetme	Shuma totale
1.	Furnizim me materiale lulore	5000	5000	/	5000	60	300.000 den
2.	Mbjellje	5000	5000	1	5000	6	30.000 den
3.	Gërmim,nxjerrje (mirëmbajtje)	5000	5000	7	35000	8	280.000 den
							GJITHSEJ: 610.000 den.

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare

Shtrati i lumbit Sushica

Nr.ren.	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m ²	6.860	14	96.040	0,20 den.	19.208 den.
2.	Kositje me makinë	m ²	5.000	14	70.000	0,60 den.	42.000 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m ²	1.860	14	26.040	1,20 den.	31.248 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m ²	6.860	14	96.040	0,60 den.	57.624 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m ²	6.860	14	96.040	0,10 den..	9.604 den.
					Gjithsej:		159.684 den

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
rr."Marshall Tito"

Nr. ren.	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m ²	650	34	22.100	0.20 den	4.420 den.
2.	Kositje me makinë	m ²	585	34	19.890	0,60 den	11.934 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m ²	65	34	2.210	1,20 den	2.652 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m ²	650	34	22.100	0,60 den	13.260 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m ²	650	56	36.400	0,10 den	2.210 den.
6.	Ujitja e barit me dorë	m ²	650	56	36.400	1,10 den	40.040 den.
7.	Prerje të gardhit të gjallë	m ²	70	3	210	35 den	7.350 den.
8.	Gërrmimi i shkurreve	Nr.	34	2	68	40 den	2.720 den.
9.	Prerja e drunjve në rresht	Nr.	160	1	160	230 den	36.800 den.
10.	Ngarkimin e degëve	m ³	30	1	30	500 den	15.000 den.

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
rr. Boris Kidriç

Nr. rendor	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m ²	670	14	9.380	0,20 den.	1.876 den.
2.	Kositje me makinë	m ²	590	14	8.260	0,60 den.	4.956 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m ²	80	14	1.120	1,20 den.	1.344 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m ²	670	14	9.380	0,60 den.	5.628 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m ²	670	14	9.380	0,10 den.	938 den.
6.	Krasitja e luleve sezonale	nr.	300	2	600	35 den.	21.000 den.
7.	Mirëmbajtja e sipërfaqeve lulore	nr.	300	4	1200	35 den.	42.000 den.
					GJITHSEJ:		77.742 den

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
rr. "Rudnička"

Nr. rendor	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m ²	940	14	13.160	0,20 den.	2.632 den.
2.	Kositje me makinë	m ²	840	14	11.760	0,60 den.	7.056 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m ²	100	14	1.400	1,20 den.	1.680 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m ²	940	14	13.160	0,60 den.	7.896 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m ²	940	14	13.160	0,10 den.	1.316 den.
6.	Gërrmimin e shkurreve	Nr.	10	2	20	40 den.	800 den.
7.	Mirëmbajtja e trendafilave	Nr.	50	2	100	35 den.	3.500 den.

8.	Prerje të trendafilave	m^3	50	2	100	20 den.	2.000 den.
					GJITHSEJ:		26.880 den.

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
rr. "11 Shtatori"

Nr. rendor	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m^2	6800	14	58.800	0,20 den	11.760 den.
2.	Kositje me makinë	m^2	800	14	183.400	0,60 den	6.720 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m^2	6000	14	154.000	1,20 den	100.800 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m^2	6.800	14	95.200	0,60 den	57.120 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m^2	6.800	14	95.200	0,10 den	9.520 den.
6.	Krasitja e drunjëve	Nr.	220	1	220	230 den.	50.600 den.
7.	Ngarkimin e degëve	M^3	60	1	60	500 den.	30.000 den.
					GJITHSEJ :		266.520 den.

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
rr. Bulevardi i Çlirimit

Nr. rendor	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m^2	5100	34	173.400	0,20 den	34.680 den.
2.	Kositje me makinë	m^2	4.600	34	156.400	0,60 den	93.840 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m^2	700	34	23.800	1,20 den	28.560 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m^2	5.100	34	173.400	0,60 den	104.040 den.

5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m^2	5.100	34	173.400	0,10 den	17.340 den.
6	Krasitja e drunjëve	Nr.	360	1	360	230 den.	82.800 den.
7	Ngarkimin e degëve	m^3	50	1	50	500 den.	25.000 den.
						GJITHSEJ :	386.260 den

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
rr. Rruga Magjistrale

Nr. rendor	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m^2	15.100	14	211.400	0,20 den	42.280 den.
2.	Kositje me makinë	m^2	6.100	14	85.400	0,60 den	51.240 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m^2	9.000	14	126.000	1,20 den	151.200 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m^2	15.100	14	211.400	0,60 den	90.600 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m^2	15.020	14	211.400	0,10 den	15.100 den.
6.	Gërrmimi dhe mbjellja e trendafilave	Nr.	50	2	100	35 den.	3.500 den.
7.	Prerja e trendafilave	Nr.	50	2	100	20 den.	2.000 den.
8.	Krasitja e drunjëve	Nr.	580	1	580	230 den.	133.400 den.
9.	Ngarkimi i degëve	m^3	60	1	60	500 den.	30.000 den.
						GJITHSEJ:	519.320,00den.

KONTROLL

i punëve operative me intensitet të mbajtjes së gjelbërimit publik dhe mjeteve të nevojshme financiare
“Kitino Kale” –parcelat P 3,5,6,7,8,dhe 10

Nr. rendor	Operacioni punës	Masa e vetme	Sasia	Sa herë	Gjithsej	Çmimi i vetëm	Gjithsej shuma
1.	Grumbullimin e mbeturinave dhe pastrimin e barit	m ²	13.560	14	189.840	0,20 den	37.968 den.
2.	Kositje me makinë	m ²	1.150	14	16.100	0,60 den	9.660 den.
3.	Kositje me makinë me shpin zingjiri	m ²	12.410	14	173.740	1,20 den	208.488 den.
4.	Mbledhja e barit të kositur	m ²	13.560	14	189.840	0,60 den	113.904 den.
5.	Ngarkim me dorë i barit të kositur	m ²	13.560	14	189.840	0,10 den	18.984 den.
6.	Gërmimi i shkurreve	Nr.	200	2	400	40 den	16.000 den.
7.	Krasitja e luleve sezonale	Nr.	600	2	1.200	35 den	42.000 den.
8.	Mirëmbajtja e sipërfaqeve lulore	Nr.	600	4	2.400	35 den	84.000 den.
9.	Krasitja e drunjëve	Nr.	200	1	200	230 den	46.000 den.
10.	Ngarkimi i degëve	m3	40	1	40	500 den	20.000 den.
						GJITHSEJ :	597.004 den.

REKAPITULAR I SHQYRTIMIT KADASTRAL DHE MJETEVE FINANCIARE

Numri Rendor	Lokacioni	Hapësira:	Vlera e përgjithshme.
1.	Shtrati i Lumin Sushica	6.860 m ²	159.684 den.
2.	Rr. Marshall Tito	650 m ²	136.386 den.
3.	Rr. Boris Kidriç	670 m ²	77.742 den.
4.	Rr. Rudnička	940 m ²	26.880 den.
5.	Rr. 11 Shtatori	6.800 m ²	266.520 den.
6.	Bul. i „Çlirimt“	5.100 m ²	386.260 den.
7.	Kalaja	13.560 m ²	519.320 den.
8.	Rruja Magjistrale	15.100 m ²	597.004 den.
GJITHSEJ:		49.680 m²	2.169.796 denarë

2. SHËRBIME TË POSAÇME

2.1 TRANSPORTI I KAFSHËVE TË NGORDHURA NË DEPONINË E CAKTUAR(GROPË) JASHTË QYTETIT

- Transport i kafshëve të ngordhra të ngarkuara, një turnë – 2.000 den.
- Mbledhja veçmas e kafshëve të ngordhura – 200 den. Për kafshë.

Nga praktika e deritanishme, në vit, në Komunën e Kërçovës bëhet mbledhja e kafshëve të ngordhura:

- 4 herë x 50 kafshë = 200 kafshë
- 200 kafshë x 300 denarë = 60.000 denarë
- 4 herë x 2 turne = 8 turne në vit x 2000 denarë = 16.000 denarë

GJITHSEJ: 40.000 den. + 16.000 den. = 76.000 den.

2.2. VENDOSJA E FLAMUJVE SHTETËROR

Për vendosje të flamujve shfrytëzohet automjet kamion, i cili përveç drejtuesit ka edhe 2 punëtorë tjerë, ose për një vendosje nevojiten 4 orë

2 punëtor x 4 x 130 = 1440 den

1 kamion x 4 x 1200 = 4.600 den

Gjithsej= 6.040

Gjithsej: në vit – 16 festa x 6.040 = 96.640 denarë

2.3 PASTRIMI I SHTRATIT TË LUMIT SUSHICA

Për shkak të zvogëlimit të prurjeve të ujit në lumin Sushica, lumi shpesh gjatë vitit mbushet me barëra të rritura, mbeturina nga toka dhe mbeturina tjera, gjë që shkakton mbushjen dhe trashjen e shtratit të lumit Sushica dhe gjatë reshjeve të dendura lumi derdhet nga shtrati i lumit.

SHQYRTIM

I pastrimit të lumit Sushica, katër herë në vit e shprehu në orë pune

Nr. rend.	Operacioni i punës	Masa e vetme	sa Herë	Gjithsej	Gjithsej orë	Çmimi i vetëm	Gjithsej Shuma
1.	Pastrim me mini-eskavator në orë	1600 metre	4	6400 metre	196	2.000 den.	392.000 den.
2.	Angazhimi i dy punëtorëve me kualifikim të ulët	/	4	6400 metre	392	120 den.	47.040 den.
3.	Ngarkimi i barit, dheut dhe sedimentit nga shtrati i pastruar	/	4	/	48	2.000 den.	96.000 den.
4.	Transport me kamion Mercedes/Atego	/	4	48 turne	/	1.500 den.	72.000 den.
						GJITHSEJ:	607.040 den.

2.4 PASTRIMI I DEPONIVE TË EGRA

Pastrimi i deponive të egra është praktikë ke ne. Gjegjësisht, flitet për kujdes për hedhurinat që janë prodhim i sjelljes jo korrekte të qytetarve dhe personave juridik në qytetin e Kërçovës.

Kjo sjellje jo korrekte si pasojë e ka mbeturinat e mbeturave për të cilin në vend që të përgjigjet kryersi konkret, kalon në domenin e hedhurinave publike, mbeturinave të lëshuara si dhe harxhimet për mbledhje të këtyre hedhurinave ashtu bëhen pjesë e harxhimeve komunale, e cila alimentohet nga Buxheti i Qytetit të Kërçovës.

Pastrimi i hedhurinave të mbeturave si deponi të egra do të bëhet në pajtim me çmimoren e shërbimeve të NP “Komunalec”- Kërçovë, dhe sipas procedurës/urdhëresës të përcaktuar nga Komuna e Kërçovës.

2.4. FURNIZIM ME PAJISJE URBANE KOMUNALE

Dispozitat e parapara të kundërvajtjeve në Ligjin për pastërti publike parashohim masa rigorozë, si ndaj qytetarve, ashtu edhe ndaj subjekteve publike, për atë është e patjetërsueshme hapësirat publike të jenë të pajisura me enë speciale për drejtimin me hedhurinat komunale dhe mbeturinave, siç janë enët për mbeturina prej 1,1m³, enë prej 0,5 m³, shporta për mbeturina për parquet, enë për plastika, enë për letra. Poashtu janë të nevojshme mjete për mirëmbajtjen e veç të vendosurat enë dhe shporta. Kjo masë do të sjellë për zvoglimin e reakcioneve nga ana e shfrytëzusve për pajisje të pamjaftueshme në hapësirat publike me pajisje të nevojshme. Për këtë masë është planifikuar të sigurohen **2.000.000** denarë në vit.

Nr.rend.	Përshkrim	Sasia	Çmimi i ve.	Gjithsej
1.	Karroca dore për mbeturina	10	2.000	20.000
2.	Lopata dhe fadroma	50	600	30.000
3.	Furnizimi i fshesave	5000	40	200.000
4.	HTZ pajisje për të punësuarit	52	1.500	78.000
5.	Furnizimi i makinave, trimerëve dhe pajisjeve tjera për kositje	/	/	300.000
			GJITHSEJ	628.000 denarë

2.VËREJTJET THEMELORE ME PROPOZIM MASA TË RËNDËSISHME

Kështu materiali i prezantuar paraqet minimumin e konstrukcionit financiar për realizim të operacioneve të parapara me programin për kryerje të punëve për mirëmbajtje të pastërtisë publike për vitin 2022 në Komunën e Kërçovës, me që rast u mbajt llogari për aspektin social të shfrytëzuesve të shërbimit.

Me qëllim vendosje të mardhënieve reale respektivisht në mes Ndërmarrjes Publike Komunale dhe shfrytëzuesve të shërbimve të saj, është e nevojshme të sigurohen mjete për realizimin e këtij programi, dhe në pajtim me Ligjin për Pastërti Publike, vijon të përcaktohet lartësia e kompenzimit për mirëmbajtje të pastërtisë publike.

Gjithsej shuma që është e nevojshme për realizimin e këtij programi i ndarë me numrin e shfrytëzuesve të Komunës së Kërçovës do ta jap shumën vjetore, përkatësisht mujore të mjeteve monetare me të cilat duhet të vërtetohet me vendim nga Këshilli i Komunës së Kërçovës.

Sipas të dhënave që N.P.Komunalec – Kërçovë i ka si numër të shfrytëzuesve, subjektet juridike mund të grupohen në 3 kategori: të vogla, të mesme dhe të mëdha, dhe në vendimin për përcaktimin e kompenzimit për pastërti publike, kompenzimi do të ishte 1:1; 2:1; 3:1 në relacion me lartësin e kompenzimit për personat fizik si shfrytëzues.

Në këtë kompenzim do të jenë të siguruara mjete për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, me që rast do të ndalohet harxhimi i deritashëm i pa ligjshëm i mjeteve nga kryerja e shërbimeve tjera komunale - furnizim me ujë, mbledhja e hedhurinave komunale dhe të tjera, dhe me atë edhe gjendje me stabile financiare e N.P. Komunalec – Kërçovë si realizues i këtij programi.

Këto mjete, të mbledhura nga kompenzimi për mirëmbajtje të pastërtisë publike, në pajtim me Ligjin për Pastërti Publike, do të jenë të ardhura për Komunën e Kërçovës dhe do të shfrytëzohen për financim të punëve nga pastërtia publike.

Mbikqyrjen e realizimit të këtij programi në pajtim me ligjin për pastërti publike do ta realizojnë mbikqyrësit komunal dhe inspektorët komunal.

REKAPITULAR

PASTRIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE	10.484.565,60 den.
LARJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE	2.520.000,00 den.
MIRËMBAJTJA E GJELBËRIMIT PUBLIK	2.169.796,00 den.
PASTRIMI I LUMIT SUSHICA	607.040,00 den.
BARTJA E KAFSHËVE TË NGORDHURA NË DEPONINË E CAKTUAR (GROPË) JASHTË QYTETIT	76.000,00 den.
VENDOSJA E FLAMUJVE SHTETËROR	96.640,00 den.
FURNIZIM ME PAJISJE URBANE KOMUNALE	2.000.000,00 den.
FURNIZIM ME MAKINA, PAJISJE DHE HTZ PËR TË PUNËSUARIT	628.000,00 den.
RRETH-RROTULLIME DHE KALAJA (MBLEDHJA DHE MIRËMBAJTJA E SIPËRFAQeve LULORE)	913.000,00 den.
GJITHSEJ:	19.398.401,60 den.

**Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar**
